



Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.4, 15.1 pika (a), (c), (e), (f), (j), (k) dhe 21.2 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të rregullimit të aktiviteteve të aviacionit të lidhura me sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (RPAS) me peshë më të vogël se 20 kilogram, që operojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës dhe me qëllim të zhvillimit dhe lehtësimit të aktiviteteve të RPAS duke ofruar kushte të pranueshme për operim të sigurt,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesit, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesit,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 6/2014 PËR
SISTEMET E MJETEVE AJRORE PA PILOT ME PESHË MË TË VOGËL SE
20 KILOGRAM**

**Neni 1
Zbatueshmëria**

Kjo Rregullore zbatohet për aktivitetet e aviacionit civil të lidhura me sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (RPAS), në territorin e Republikës së Kosovës, që peshojnë më pak se 20 kg, përveç balonëve të lirë pa pilot.

**Neni 2
Definicionet dhe shkurtesat**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje, përkufizimet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

Mjet ajror - nënkupton çdo mjet që mbështetet në ajër nga reaksionet e ajrit, përveç reaksioneve të ajrit kundër sipërfaqes së tokës.

AAC - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, të themeluar sipas Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil.

Leje e KTA-së - nënkupton pëlqimin zyrtar me shkrim ose me gojë nga njësia e Kontrollit të Trafikut Ajror.

KFOR J3Air - nënkupton zyrtarin përgjegjës për operimet ajrore ushtarake dhe civile në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, fushëveprimi i të cilit është përcaktuar në Rregullat për mjetet ajrore që operojnë si Trafik i Përgjithshëm Ajror (ang. GAT) në Hapësirën e Përbashkët të Operimeve Ajrore në Ballkan (ang. JOA), të cilat mund të amendamentohen kohë pas kohe nga komandanti i Qendrës së Bashkuar për Operimet Ajrore (ang. CAOC) të NATO-s.

MHz - nënkupton njësinë e frekuencës të barabartë me një milion hercë.

Hapësirë për fluturim të modeleve - nënkupton vendin me dimensione të caktuara të destinuar për përdorim ekskluziv nga një (disa) përdorues i veçantë.

Operator - nënkupton personin, organizatën apo ndërmarrjen e angazhuar, apo e cila ofrohet për t'u angazhuar, në operimet me mjete ajrore.

Mjet ajror pa pilot (RPA) - nënkupton mjetin ajror pa pilot, i cili pilotohet nga stacioni i largët i pilotimit dhe i cili peshon më pak se 20 kg.

Sistem i mjetit ajror pa pilot (RPAS) - nënkupton mjetin ajror pa pilot (RPA), stacionin(et) e tij të largët të pilotimit, linjat e nevojshme të komandimit dhe kontrollimit, si dhe komponentët tjerë të specifikuar në dokumentacionin e dizajnit të tipit.

Operim me vijë të drejtë vizuale - nënkupton operimin në të cilin ekuipazhi nga largësia mban kontakt të drejtpërdrejtë vizual me mjetin ajror për ta menaxhuar fluturimin e tij dhe për t'i përmbushur përgjegjësitë për ndarje dhe shmangie të përplasjeve.

Neni 3 **Dispozita të përgjithshme**

3.1 Pronari apo operatori i një RPAS është përgjegjës që fluturimet e mjetit ajror të bëhen në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

3.2 Pronari apo operatori i RPAS nuk duhet të shkaktojë apo lejojë që ndonjë send ose kafshë, qoftë ajo e lidhur me parashute apo pa të, të lëshohet nga mjeti ajror pa pilot, me ç'rast do të rrezikonte personat apo pronën.

3.3 Pronari apo operatori i një RPAS mund të drejtojë mjetin ajror vetëm nëse mund të sigurohet në mënyrë të arsyeshme se fluturimi mund të kryhet në mënyrë të sigurt.

3.4 Pronari apo operatori i një RPAS duhet të mbajë kontakt vizual të drejtpërdrejtë, të pandihmuar, dhe të mjaftueshëm për të vëzhguar trajektoren e

fluturimit të RPAS në raport me mjetet tjera ajrore, personat, veturat, anijet dhe strukturat tjera, me qëllim të shmangies së ndeshjes.

3.5 Pronari apo operatori i një RPAS, nuk mund të drejtojë mjetin ajror për qëllime të punëve nga ajri dhe të pajisur me mjete fotografimi apo detektimi nga largësia, pa lejen e veçant të lëshuar nga AAC-ja, krahas lejes së lëshuar sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje.

Neni 4 Leja e operimit

4.1 Pas parashtrimit të kërkesës për të operuar me RPAS, AAC-ja e shqyrton kërkesën në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje.

4.2 Gjatë shqyrtimit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, AAC-ja do të koordinojë me njësinë e KFOR J3-Air para lëshimit të lejes së operimit me RPAS.

4.3 Pasi të jenë plotësuar kushtet e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, AAC-ja lëshon lejen për të operuar me RPAS.

Neni 5 Kushtet e operimit

5.1 Kushtet e përgjithshme

Për fluturimet me RPAS, aplikohen rregullat në vijim:

- a) Fluturimi duhet të kryhet në atë mënyrë, ashtu që asnjë person tjetër ose pronë të mos rrezikohet dhe rrethina të shqetësohet sa më pak që të jetë e mundur;
- b) Fluturimi duhet të kryhet brenda 500 metrave nga operatori gjatë gjithë kohës;
- c) Jashtë hapësirës së kontrolluar, përveç me leje të KTA-së;
- d) Jashtë çdo zone me trafik të aerodromit, përveç me leje të KTA-së;
- e) Jashtë çdo baze ajrore ushtarake apo zonave të kufizuara/ndaluara;
- f) Distanca nga zonat e ndërtuara dhe rrugët kryesore publike duhet të jetë së paku 150 m;
- g) Niveli i fluturimit nuk duhet të tejkalojë 100 m mbi tokë;
- h) Fluturimi mbi zona me ndërtime të dendura, duke përfshirë zonat me shtëpi vikendi dhe zonat për kamping, si dhe zonat e gjera të hapura ku mblidhen njerëzit, nuk është i lejuar;
- i) Fluturimi mbi zonat e veçanta me ndjeshmëri ambientale nuk është i lejuar.

5.2 Rregullat e veçanta (modelet e mëdha)

Për fluturimet e RPAS me masë të ngritjes më të madhe se 7 kg dhe më të vogël se 20 kg, duke përfshirë karburantin, dhe për RPAS që përdorin fuqinë e motorit(ëve)

reaktiv me turbina, përveç dispozitave të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, aplikohen rregullat në vijim:

- a) RPAS duhet të jetë i pajisur me instalim të radio-kontrollit;
- b) Fluturimet duhet të kryhen vetëm nga një hapësirë e aprovuar për fluturim të modeleve, në përputhje me paragrafin 3 (b) të këtij neni dhe brenda hapësirës së përkufizuar ajrore që i takon hapësirës për fluturim të modeleve, në përputhje me paragrafin 3 (a) të këtij neni;
- c) Fluturimet nuk duhet të kryhen pa u lëshuar polica e sigurimit për përgjegjësi ndaj palëve të treta, në përputhje me nenin 93 të Ligjit Nr. 03/L-051 për aviacionin civil;
- d) Fluturimet duhet të kryhen nga pronari apo operatori, fushëveprimi i të cilit është operimi me modele të mëdha RPAS në baza amatore dhe në përputhje me rregulloret përkatëse të lëshuara nga AAC-ja;
- e) Çdo mjet ajror model me motor, i pajisur me marrës që është në gjendje të operojë në mënyrën e dështimit të sigurt (*failsafe*), duhet të ketë pajisjet e dështimit të sigurt, si minimum, në mënyrë që të zvogëlojë shpejtësinë e motorit në gjendjen neutrale (*idle*) në rast të humbjes apo prishjes së sinjalit.

5.3 Hapësira për fluturim të modeleve dhe hapësira ajrore

Me qëllim të përdorimit të një fushe si hapësirë për fluturim të modeleve, duhet të zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, si dhe kushtet në vijim:

- a) Duhet të ekzistojë një hapësirë ajrore përreth fushës që mbulon një zonë prej së paku 100 x 300 m;
- b) Hapësira për fluturim të modeleve duhet të aprovohet nga AAC-ja. Aplikacioni për aprovim duhet të përmbajë hartën e zonës dhe përshkrimin e hapësirës për fluturim të modeleve dhe hapësirën e tij ajrore;
- c) Për t'u përdorur hapësira si hapësirë për fluturim të modeleve, duhet të merret leja nga pronari ose nga ndonjë person tjetër fizik apo juridik, i cili ka të drejta apo interes pronëso-ro-juridik. Pronari apo personi tjetër i tillë, i zonave të mbuluara nga hapësira ajrore e hapësirës për fluturim të modeleve duhet të njoftohet paraprakisht për aktivitetet.

Neni 6

Instalimet e radio-kontrollit

6.1 Transmetuesit/pranuesit e modeleve të mjeteve ajrore të kontrolluara përmes radio-sinjalit, duhet të përmbushin kërkesat në përputhje me Ligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet elektronike, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e ndarjes dhe shfrytëzimin e radio-frekuencave.

6.2 Radio-kontrollimi i RPAS, i mbuluar në paragrafin 2 të nenit 5, duhet të kryhet në përputhje me Planin kombëtar të radio-frekuencave, kornizën rregullatore të Bashkimit Evropian dhe legjislacionin vendor për resurset e komunikimeve elektronike.

Neni 7
Rishikimi i vendimeve

Ankesat kundër vendimeve të marra nga AAC-ja në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, mund të dorëzohen në Komisionin e Ankesave, në përputhje me ligjin e aplikueshëm.

Neni 8
Përrjashtimet

Pavarësisht përmbushjes së kushteve sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje, AAC-ja mund të tërheqë aprovimin e lëshuar apo t'ia refuzojë lëshimin e aprovimit pronarit apo operatorit të RPAS, ose të kërktojë ndalimin e menjëhershëm të operimeve të RPAS. Veprimet e AAC-së, të marra sipas dispozitave të këtij neni, duhet të arsyetohen në mënyrën e duhur.

Neni 9
Masat ndëshkuese

9.1 Çdo person që vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 5, paragrafi 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje, dënohet me gjobë në përputhje me nenin 96 ose 97 të Ligjit Nr. 03/L-051 për aviacionin civil.

9.2 Çdokush që operon një hapësirë për fluturim të modeleve në kundërshtim me dispozitat e nenit 5, paragrafi 3, të kësaj Rregulloreje, dënohet me gjobë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 8 prill 2014.

Në Prishtinë, 24 mars 2014.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i përgjithshëm